SHOQNI PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË SHQIPNIS

S. V. E. A.

RELACJON

mbi Bilancin më 31 dhetuer 1926

i parashtruem

Asembles së Përgjithshme t'Akcjonisvet

më 27 prill 1927

BKSH

BKSH

SHOQNI PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË SHQIPNIS

S. V. E. A.

RELACJON

mbi Bilancin më 31 dhetuer 1926

i parashtruem

Asembles së Përgjithshme t'Akcjonisvet

më 27 prill 1927

BKSH

BK-SH

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Shk. e T. Mario Alberti, Ministër Fuqiplot, *Ndën-Kryetar.*

Av. Amedeo Gambino, *Këshilltar-Sekretar dhe Mis i Komitatit.*

Kav. i Kr. të M. Av. Giuseppe Bianchini, *Këshilltar dhe Mis i Komitatit.*

Ragj. Ugo Viali, *Këshilltar dhe Mis i Komitatit.*

Shk. e T. Principi Francesco Boncompagni-Ludovisi, *Këshilltar.*

Gr. Uf. Ingj. Pietro Fenoglio, *Këshilltar.*

Kom. Fulvio Geremia, »

Shk. e T. Ekrem Bey Libohova, »

Patuk Saraçi, »

Kom. Mario Solza, »

I Nd. Milto Tutulani, »

BKSH

BKSH

RELACJON I KËSHILLIT T'ADMINISTRIMIT

Vepra e Shoqnis s'onë, në vjetin e dytë të veprimit, ka hye në fazen e realizimit konstruktiv.

Detyren që kemi marrë përsipër në fillim t'aktivitetit t'onë ka qenë e madhe edhe e haptë: me i dhanë Qeveris së Republikës së re Shqiptare mjete financore të mjaftueshme për me mujtë me ba ball vepravet botore ma me rândsì per konsolidimin ekonomik dhe qytetnuer të Shqipnis.

Mbassì u rregullue gjendja politikore e mbrendshme, Qeverija Shqiptare mori para sysh nevojen me shpërthye rrethin e izolimit në të cillin ekonomija e Vendit u gjindte shkak mungese mjetesh komunikimi. Mjafton me përmendë që mungesa e limanevet të sigurta mbi brigjet shqiptare bante të fshtirë zhgarkimin e teshavet edhe t'udhtarvet, i cilli zhgarkim ishte gadi i pamundshëm në nji numër të math ditësh me mot të keq e që mungesa e rrugavet e t'uravet mbi lumenjët mâ të mdhej të Shqipnis, që u përgjajnë projevet t'egra, pengojshin fort tue ba nga nji herë e pamundun me sigurue lidhje të rregullshme ndërmjet visevet të ndryshme të Shqipnis, kështu që

Vendi del me të vërtete i ndam në zona fare të nderlikueme. Për me u ba ball nevojavet të tilla Shteti Shqiptar, në fillim të vjetit 1925, lidhte me Grupin financuer Italjan — promotor i konstituimit të Shoqnis s'onë ashtu edhe i konstituimit të Bankës Kombëtare të Shqipnis — nji Uha për Punë Botore të Shqipnis me nji shumë të dlirë pesëdhetë miljonash Frangë Ar edhe paravente si kusht absolut për konstituimin e Bankës derdhjen e plotë t'Uhas (1).

Tanì, me gjithë ate që për garancì t'Uhas nga ana e Shqiptarve, i ishin dhanë Shoqnis s'onë privilegje absolute dhe të pambrapathirrshme mbi t'ardhunat kryesore të Shtetit, e kjo mbi doganat edhe mbi monopole të krypes, të shkrepcavet, të letres së cigarevet e të letravet loje, nga pikëpamje financore emisjoni i Uhas do t'ishte qenë fort problematik, mos me pasë qenë përmbajtë dhe mbështetë veprimi i Shoqnis s'onë nga ana e Qeveris Italjane.

Përkrahje e tillë — e sidomos nga ana e interesamentit personal të Shkeleqësis së Tij Musolinit, që ka dashtë edhe mbi këtë fushë me i dhanë popullit shqiptar nji dishmì mirëdashjeje të veçantë — u vërtetue me akte të Qeveris Italjane, e cilla, mbassì i akordojë në favor t'Uhas lirim prej taksavet shtet-

---

(1) Të shifet n. 40 i Fletores Zyrtare me 31 Korrik 1925 kû ne faqen 22 shifet e caktueme nga Qeverija Shqiptare se « Në kjoftë se Shoqnija per Shvillimin Ekonomik të Shqipnis nuk derdhë shumen e tânë franga àr pesëdhelë miliona, kontrata e Bankës Kombëtare e Shqipnis vjen e prishun ».

URA HEKURI MBI ERZENIN AFËR SHËN JAKUT

Që sigurou lidhjen e Kryeqytetit të Shqipnis me Limanin e saj.

BISHT

NJI PREJ URAVET NE ÇEMENT MBI RRUGËN DURRËS-TIRANË

BK

nore (2), âsht perkujdes për me garantue me anen e Thesarit Mbret. pagesen e përvjetshme t'Uhas (3).

Asht e interesantshme me e përmendë këtu relacjonin me të cillin Shkelqësija e Tij Ministri i Financavet Conte Volpi di

---

(2) Me Dekret Ligjë Mbretnore n. 631 me 3 Prillë 1926, shpallun në Gazeten Zyrtare të Mbretniss' Italís n. 93 me Prillë 1926 si vijon:

Art. I.

Shoqnija per Shvillimin Ekonomik të Shqipnìs âshtë e autorizueme me nxjerrë detyrime deri në 70.500.000 franga àr t'êmnuem dhè kundra qyshkeve të caktueme nga artikulli 171 e t'atyne vazhdues të Kodit të Tregtìs në veprim per nxjerrjen e detyrimeve.

Art. 2.

Të gjitha vendimet, kontratat e përgjithsisht të gjitha Konvencionet q'i-përkasin Uhas për Pûnët Botore të Shqipnìs, tue përshimun Konvencjonet e lidhuna nga Qeverija Shqiptare si edhé dêtyrimet e titujt përkatës, kjofshin dhé me daté mâ të përparshme të këti Dekreti, janë te perjshtuem nga taksat e drejta te tashme e t'ardhshme.

Dhè detyrimet kanë m'u nxjerrë falë në kuotacjon prânë të gjitha Bursave të Vlefteve.

Art. 3.

Shoqnija per Shvillimin Ekonomik të Shqipnìs âsht e shgarkueme nga pagesa e taksave mbi pûnët per dhetë vjetë, tue fillue nga data e këti dekreti, me qênë se aktiviteti i sajë âshtë drejtue për përmushjen e pûnimeve botëre por të cillat âshtë shenjue Uhaja.

Por për këtë periudhe janë të përjashtuem nga taksat e drejta fitimet e industrisë te Shoqnis thanun.

Ky dekret ka m'u paraqit Parlamentit për këthimin në Ligjë. Ministri proponues âshtë i autorizuem për paraqitjen e përpilimit përkatës të Ligjes.

(3) Me Dekret Ligjë Mbretnuer n. 249 me 3 marc 1927, shpallun në Gazeten Zyrtare të Mbretnìs Italis n. 55 me 8 marcë 1927 si vijou:

Art. 1.

Ministri i Financavet âshtë i autorizuem me vendue në kapitull të veçantë të bilancit pasiv të Ministrìs së Financavet shumat e duhuna per të sigurue shërbimin e Uhasë per Pûnët Botore të Shqipnìs 7.50 % të nxjerruna nga Shoqnija për Shvillimin Ekonomik të Shqipnìs për Franga àr shqiptàr 70.500.000 në themel të Konvencjonit me 29 maji 1925 e n'akord zbatues me 26 korrik 1925 të lidhun nga Shoqnija me Qeverinë Shqiptare q'i bashkanjiten këtij Decreti,

Misurata, i a paraqitte Parlamentit planin e ligjes për garancì të Thesarit Mbr.:

« Asht e tepert që të përshkruejë raportet që janë ndërmjet « t'Italis edhe të Shqipnis, mbassì asht paraqitë aprovimit t'Uej « teksti i paktit të miqsis e të sigurimit të ndënshkruem në Ti- « ranë më 27 nanduer 1926, i cilli asht dishmì mâ e madhe e « raportavet të tilla mbi fushen polikore. Por edhe mbi fushen « ekonomike Qeverija Kombëtare nuk ka mujtë me i dhanë « popullit shqiptar, me të cillin e lidhin tradicjone të vjetra « miqsijeje edhe marrëveshtjeje shpirtnore, nji provë konkrete « të bashkëpunimit për me vue atë Shtet n'udhnahë të jeteses së « kënaqshme e të zhvillimit modern për të cillin shum burime e « kanë shenjue. Kështu pra Qeverija Mbr. ka kërkue me lehtsue « kompitin e Shoqnis per Zhvillim Ekonomik të Shqipnis, pro- « grama e së cilles âsht me i dhanë Shtetit Shqiptar mjetet e « nevojshme për me i ba ball programes së gjanë të punve bo- « tore. Për atë qëllim Qeverija Kombëtare nuk ka pasë fshtirsì « me dhanë garancin e Italis per shërbimin e Uhas që Shoqnija « vetë i ka akordue Qeveris Shqiptare ».

---

si edhé në themel te deklaratave siguruese të shpalluna nga Qeverija Shqiptare në Gazeten Zyrtare Shqiptare me 26 marc 1926 qi bashkëlidhen këtij Dekreti.

Art. 2.

Pagesa e kisteve për kamatat e amortizimet, si mbas Konvencjonit e akordit të parathanun, ka m'u krye nga Thesari Mbretnuer mbi kerkesen e Shoqnis për Shvillimin Ekonomik të Shqipnis. kursè Qeverija Shqiptare nuk do ketë depositue valutat e duhuna për pagesen e kisteve parathanuna, mbrenda kufizimeve të parapame po n'atà akorde.

Ky Dekret ka m'u paraqit Parlamentit per këthimin në Ligje. Ministri proponues âshtë i autorizuem për paraqitjen e përpilimit përkatës të ligjes.

SHTRATI I LUMIT MAT

Në fillim të punimevet per ndertimin e urës.

BKSH



Gatitjet per ndertimin e URËS MBI MATIN

Mbeshtetje e dhanun nga ana e Qeveris Italjane ka ba që kemi mujtë me vendue obligacjonet e Uhas, për nji shumë nominale Frangë Ar 70.500.000, të venduemit e kryem n'Italì pranë Konsorcit të Bankavet, në krye të cillavet — sikur përherë për operacjone të tilla — âsht Istituto Nazionale di Cambi con l'Estero, për nji shumë të dlirë Frangë Ar pesëdhetë miljona, ekvivalenti i së cilles në Lira Italjane 242.794.000, (i caktuem në bazë të kursit të dites t'emisjonit, 12 nanduer 1925, a me kurs nji Frang Ar=Lit. 4.85588) u depozitue pranë Bankës Kombëtare të Shqipnis e prej kësaj pranë Istituto Nazionale per i Cambi con l'Estero, a pranë organizimit mâ të math financuer të Shtetit Italjan e të Banca d'Italia bashkarisht.

* * *

Përkrahje financore e akordueme prej Qeveris Italjane Shoqnis s'onë, na ka dhanë rasë t'u përgjegjim gjanisht kërkesavet të shumta të Qeveris Shqiptare, tue lehtsue në masë të jashtëzakonshme barrat që Shteti Shqiptar në fillim ka pasë marrë përsipër për shërbimin e Uhas.

Janë të njoftuna botime të bâme mbi Fletoren zyrtare të Republikës Shqiptare mâ parë (4) e mbi Fletoren Zyrtare të Mbretnis s'Italis mâ vônë (5), kushtet e caktueme për emisjonin e Uhas edhe shërbimi relativ t'amortementevet dhe t'interesavet në « Konvencjonin e Uhas » 29 maj 1925 edhe në « Marrëveshtjen Egzekutive » më 26 korrik 1925.

---

(4) « Fletoria Zyrtare » n. 36 më 12 korrik 1925 e n. 40 me 31 korrik 1925.
(5) N. 55 me 8 marc 1927 faq. 1028 e vazhd.

Disa nota eksplikative të Konvencjonit, të komunikueme me kohë Përfaqësuesvet të Shtetit Shqiptar tregojnë si në shum pikëpamje kushtet e caktueme në fillim kanë qenë veçanarisht të favorshme për Shqipnin.

Ndërmjet të tjeravet âsht për t'u përmendë prova e madhe e besimit e e liberalitetit që Grupi Financuer Italjan deshte t'i tregojë Shqipnis. Shoqnija e jonë, me të vërtetë âsht kufizue që të bajë shërbimin e thjeshtë e agjentit pagues të vepravet botore që janë për të bâm me të hollat e Uhas, përkundrazi në rasë t'uhanavet ndërkombëtare të fundit, të nxjerruna ndën auspicet e Ligës së Kombëvet, Shteti debituer asht ndënvue njij kontrolli të rrept mbi të gjitha veprimet financore dhe administrative.

Përveç kësaj Shoqnija e jonë mbas kërkeses shqiptare, pranoj ç'në fillim t'a lirojë Qeverin Shqiptare prej pageses së dy semestravet të para të shërbimit t'amortementevet e t'interesavet, kështu që Shqipnija tue pasë në dispozicjon të saj të gjithë shumen e Uhas, prej 12 nanduer 1925, ka qenë e detyrueme me fillue pagesat prej semestrit të tretë, a prej semestrit dielluer të dytë të vj. 1926.

Por para se të kalojë koha e pagesës Qeverija Shqiptare — tue mos pasë në bilanc mjetet e nevojshme — paraqitte kërkesen që të lirohet prej pagesavet me të holla e për këtë Shoqnija e jonë u përkujdes, me liberalitatin e math, me nji marrëveshtje egzekutive më 27 qershuer 1926.



URA MBI MATIN
(E pame prej bregut).

BIBLIOTEKA



URA MBI MATIN
(E pame prej malit).

BIBLIT

— tue marrë përsipër që t'i përgjegji Banka Kombëtare e Shqppnis, mbi të hollat e Uhas së depozitueme pranë saj në « Fond Punë Botore » të veçantë, interesat në kredit në masë të jashtëzakonshme 7%, interesat per t'i shenjue ne « Fond Shërbim Interesash » të veçantë;

— tue autorizue përdorimin e « Fondit të shërbimit t'interesavet » të përmendun për pagesen e shumes të semestravet që vien mbas të dytit.

Mandej Shoqnija e jonë, në lidhje me lirimin e takses shtetnore të caktuem prej Qeveris Italjane në favor t'Uhas, pranoi bonifikimin në favor të Shqipnis shumen e taksavet dhe t'impostavet të vendueme për Uhan. Me masë të tillë të liberalitetit të thjeshtë shumat e adebitueme Qeveris shqiptare për shumat semestrale e kalueme u paksuen afro 15% (6).

---

(6) Per me caktue përmbajtjen e kufizimet e atij konvencjoni po sjellim në dijeni sà q'i shkruente Shoqnija e jonë, (me 7 tetuer 1926), Fort te Ndersh. Fejzi Alizotit, Minister i tashëm i Financavet Shqiptare e n'atë kohë i derguemi i Qeverìs Shqiptare pranë Keshillit t'onë Administrativ:

« Ne vyim të bisedimeve qi në ditet e kalueme që pata nderin me bã me « Z. Tuaj, kam nderin t'Ju vertetoj ketò kjarime mbi kërkesat e drejtueme nga « Z. e Juaj n'êmen të Qeverìs Shqiptare mbi disà argumenta q'i perkasin Shoqnìs « për Shvillimin Ekonomik të Shqipnìs, Svea.

« I..... (lanë jashtë) .....

2. Për sà i përket kërkeses së paraqitune nga Qeverija Shpqitare me ânë të « Bankës Kombëtare të Shqipnìs, për me basë bonifikimin e 15% e llogaritun « i pervitëshem i Frangave àr 6.400.000 qi Qeverija Shqiptare i a detyron Sves « per shembimin e amortizimit e kamatave t'Uhas për Punët Botore, ma separi « i kjarova Z. s'Uaj se ajò e perqindët u caktue në menyrë aproksimative (forfait) « ne titull rimborsimi te taksave Qeveritàr q'i perkasin Uhasë (si mbas art. 8 « të Konvencjonit 29 maji 1925) e kjò giâ për kërkesen e tregueme nga Fort « të Ndërshmit Senatorë të Republikes Shqiptare, te cillët në rast të bisedimit « për ratifikimin e Konvencjonit sipërthanun, deshten të caktojnë me lidhie të « shkrueme (shpallun në faq. 36 te « Fletoës Zyrtare » n. 40 më 31 korrik 1925) »

Në bazë të marrëveshtjevet të tilla Shqipnija ka mujtë m'u lirue prej çfarëdo derdhjeje për Uhan, deri më 31 dhetuer të k., tue pasë me gjithë ate në dispozicjon të vet në Fond të Punve Botore shumen e mbetum Lit. 214.157.966,29 që mbas kambjos në fund dhetori (4.291.845) bâjnë Frangë Ar 49.898.811,88, tue pasë përdorë m'atë kohë përmbi Lit. 8.345.269,90 për pagesa veprash botore. Po n'atë kohë mbetshin përveç kësaj të shenjueme në « Fond Shërbime Interesah » Lit. 827.041,89 që bâjnë mbas kambjit në fund të dhetorit Frangë Ar 192.700,78.

* * *

Shoqnija e jonë mund t'afermojë pra që i ka sigurue Shqipnis, disponibilitetin mâ të gjanë të mjetevet të collat Shteti i ri ka mujtë me dishrue, në lidhje me shumen e bilancit të tij.

« se « të drejtat e pullave e takset qeveritare-ketò të fundit 15 për qind-kanë « m'u caktue para nxjerrjes Uhasë *në menyrë te caktueme e te pandryshueme.*

« Masandaj i kam kjarue Z. s' Uaj se aboni i kërkuem nga Qeverija Shqi- « pëtare kishte me sjellë nji ndrrim në paktet e para-caktueme ne konvencjonet « e akordimet e njoftuna e se nji perfundim i mbram, për këtë gjâ, âshtë « fare në dorë të Këshillit Administrativ.

« Kam shtue dhè se kà me kênë kujdesi i em për paraqitjen e cashtjes « në këshillë në mbledhjen e afert, e kame me kêne i kènaqun në qoftë « se Këshilli do përdori nji mënyrë të mundëshme për të lehtësue në këtë pikë « Shqipnìn, por tue marrë parasyshë se në vendet e parapame për vendosjen e « mundeshme të detyrimeve t'Uhasë, janë ketò takse mbi kupona:

« Inghiltera 20 %, Shtetet e Bashkuem 10 %, Belgji 16,50 %, Svicera 2 « deri 6%.

« 3..... (Lanë jashtë).....

Këshilltari Sekretàr
nensh. Av. A. Gambino »



PONTILI NË DURRËS
Fillim i punvet.

BIBLIOTEKA



PONTILI I DURRËSIT
Gjendja e punvet ne marc 1927.

Asht e natyrshme që asnji lehtësi financore kishte mujtë kurr me mbllue humbjet reale të domosdoshme që janë në lidhje me shumat e pafrytshme t'Uhas që mbesin të papërdorshme.

Mâ parë se u mbarue sistemacjoni i Uhas Shqnija e jonë, tue i a kërkue Qeveris Shqiptare formulimin e planit organik të të përdorunit të fondevet t'Uhas (7), âsht përkujdes me i

---

Po sjellim edhè përgjigjen q'i bâme Ministris së Financavet Shqiptare më 4 fruer 1927.

« Në lidhje të deshires së çfaqun nga ajò e Ndersh. Ministrì e në mbështeje « me sà i âshte njoftue fort Ndërsh. Kryetarit të Këshillit Kontrollues, në « rastin e misjonit të Tij në Romë ne shtatorin e tetorin 1926, si i Dergue- « mi i Qeveris Shqiptare (me letër me datë 7 tetuer 1926) mbi bonifikimin e « taksit të kuponave të 15 % Komiteti Administrativ i Shoqnis s'onë, besòn se « nuk mundet, për principë, me ndryshue art. e 8 të Konvencjonit 29 maji 1925 « e t'art. 5, t'akordit sbatues me 26 korrik 1925, me të cillët kjenë tregue në « mënyrë aproksimative e të caktueme shumat qi Qeverija Shqiptare i detyron « Shoqenis s'onë.

« Me gjithë këtë, në mënyrë fare të jashtzakoneshme, e në relacjon të « përjashtimit të taksit Qeveritàr caktue nga Qeverija Italjane me Dekret Mbre- « tnuer Ligje n. 631 më 3 prillë 1926, Komiteti ka caktue me lanë, në mënyrë « të jashtëzakonshme bonifikimin e taksave të kuponave të 15 % për përjudhen « e kalueme, por në mënyrë qi ky bonifikim nuk lypset të formojë nji shkak « për t'u invokue për sbritje analogjike të shumave t'ardhshme tue shtue e « kjarue dhè se bonifikimet analogjike, qi mund të ngjasin në kohën e ardhëshme « mund të meren para sysh vetëm kur të mbahet nga Qeverija Mbretnore Italjane « përjashtimi i naltpërmedum dhe mund të barazohen vetëm në shumen e « detyrimeve t'Uhasë të qarkullueme n'Italì, tue qênë se ndër shtete të tjera de- « tyrimet i shtrohen taksimit ».

(7) Asht për të mârrë shenjim se ç'prej kohës të përpilimit të Konvencioneve fillestare t'Uhas (15 marc 1925) Grupi Financjàr Italjan, me kujdesì të vecantë për interesat Shqiptare, vête në kjarim se, para qi të caktohet nxjerrja e Uhas për interesat Shqiptare, vête në kjarim se, para qi të caktohet nxjerrja e Uhas, âshtë e nevojshme me themelue në çfar veprimesh kishte m'u perdorë nxrjerrja po e kesajë Uhaje. Për këte qellim, si mbas akordit me 15 marc 1925, i nenshkruem prejë Ministrave të Finances, të Punve Botore e të Drejtesis, Qeverija Shqiptare u detyrote m'i paraqit Grupit Financjar Italjan, mbrenda 25

paradhanë Qereris nji shumë të parë prej nji milioni Frangë Ar, e cilla shumë u caktue prej Shqipnis për ndertim veprash botore mâ të ngutshme, si vijon:

Ura hekuri afër Sh'Jakut.
Ura Dragot-Lakli.
Punime preliminare për Uren e Matit.
Urat në çement Durrës-Tiranë.
Urat ne çement Vorrë-Milot.
Urat në çement Durrës-Rogozhinë.
Rruga e Pukes.
Rruga Elbasan-Korçë.
Rruga Berat-Fijeri-Ballësh.
Rruga Lushnje-Rogozhinë.

Ndër vepra të tilla të para âsht për t'u përmendë ura hekuri mbi Erzenin pranë Sh'Jakut edhe disa ura në çement ndërmjet Durrësit dhe Tiranës, me ndertimin e të cillavet u sigurue komunikacjoni i rregullshëm ndërmjet limanit kryesuer të Durrësit e të Tiranës, kryeqyteti i Shqipnis.

Duhet te përmendim këtu edhe të kryemit e punimevet mbi rrugen Elbasan-Korçë, e cilla punë ka përmbushë nji dishir

---

prillë, listen e plotë të gjitha pûnve botore qi do t'u vêshin në veprim me nxjerrjen e Uhas për Pûnët Botore. Shoqnija e jonë pat masandaj shkak me i u drejtue mbi këtë çashtje Qeverìs Shqiptare me letër me 1 maji e me 12 nanduer 1925.

Kjó e fundit ishte si vijon.

« Në vijm të Konvencjoneve e akordimeve të meparhme të lidhuna nga « Qeverija Shqiptare me Shoqnìn t'onë e posaçerisht ne ndjekje t'art. I. të Kon-



LIMANI DHE THARJE E DURRËSIT
E pamje e përgjithshme
(*projekt Prof. Luiggi*)

BLOT



LIMANI DHE THARJE E DURRËSIT
Plani i punvet.

(*projekt Prof. Luiggi*)

BIBLIOTEKA

të moçem, tue lidhë me Durrësin krahinen industriale të Korçes, tregtija e së cillës mê parë u përqandrote mâ fort në Salonik e ndopak në Sarandë dhe në Vlonë.

* * *

Qeverija Shqiptare me anën e Administrimit të saj të Punve Botore ka pêrpilue planin e vepravet që janë për të kryem me Uhan, tue ba projektet e vepravet mâ të rândsishme që do t'ishin për të ndërtue.

Në këtë kohë Shoqnija e jonë mjerisht nuk ka mujtë me i ndihmue Qeveris Shqiptare me bashkëpunim të drejtë, sidomos për sa i përket përpilimit të projektevet. Organizacjoni i jonë, tue qenë themelisht financuer e jo teknik, nuk kemi mujtë me i dhanë Administrimit Shqiptar nji bashkëpunim të sigurtë e të fell. Me gjithë ate nuk i ka qenë fshtirë Shqipnis m'u sigurue, tue zgjedhë lirisht ajo vetë konkursin e fuqivet teknike mâ të mira të specjalizueme për vepra të ndryshme që janë për të projektue.

« vencjonit me 29 maji 1925, q'i perket Uhas për Pûnët Botore të Shqipnis, « kemi nderin t'i lutemi asajë të Ndersh. Ministrì m'i d'hanë Shoqnis s'onë listën « e plotë të Pûnve Botore qi kanë me mujtë m'u vu në veprim me nxjerrjen « e Uhasë, qi sod u nxuernë nga Shoqnija e jonë.

« Marrim lêjen t'i bâjme të ditun asaj të Ndersh. Ministrì se kjò listë, në « themel t'akordit sbatues të dytë me 15 marc 1925, lypsej të na u paraqitej « mbrenda datës 25 prillë 1925, si i kemi kujtue dhè asaje të Ndersh Ministrì me « letren t'onë me datë 1 maji 1925.

Në Marc 1926 Qeverija Shqiptare bani listen e punvet që janë për të krye me Uhan, e cilla listë ka qenë botue në Fletoren Zyrtare Shqiptare (8) e që prejshkruejmë mâ poshtë.

Shoqnija e jonë pëlqeu dishirin shqiptar që të kryhen mâ parë kâto vepra:

— Ura mbi Matin.
— Pontili në Durrës.
— Limani edhe të thamunit e Durrësit.
— Hekurudha Durrës-Tiranë.
— Ndërtesa botore në Tiranë dhe në Durrës.
— Rruga të ndryshme.
— Studime rregullimesh të lumenjvet.

Edhe egzekutimi realizues vijoj eksportimit programatik të veprave të përmenduna, sikur do të tregojmë mâ vônë për çdo punë.

* * *

Ndërtimi me rândsì të madhe i Urës mbi lumin Mat, i kryem prej Sipermarrësit Mazorana & C. në dy pjesë (nji kryesore me gjashtë arqe nga 54 metra seecilla edhe tjetra në golenë me nand arqe nga 16,70 seecilla), duhet të përmendim veçanarisht, pse lidhë krahina të mvaruna njana me tjetren, sikur krahina Durrës-Tiranë-Mamurash, me krahinen e veriut të Shën-Gjinit-të Lezhjes-të Shkodres, komunkimi i të cillavet, sidomos në dimën, ishe gadi i pamundun.

(8) Fletorja Zyrtare n. 57 me 2 Prille 1926.

RINDERTIMI I DURRËSIT

Vila e Presidentit.

(*projekt Ark. Brasini*)

BUT



SISTEMACJONI I KRYEQYTETIT: TIRANË

E pamje e përgjithshme.

(*projek. Ark. Brasini*)

BIBLIOTEKA

Në Durrës, qendra kryesore e tregtis shqiptare, âsht tue u ndërtue prej Società Italiana Lavori Marittimi nji urë qindëdyzet metrash, që siguron nji lehtsì mâ të madhe për shkarkim n'atë liman natural, ku për shum ditë të motit të keq çdo shkarkim ka qenë i pamundun, me dam të math për Shqipnin dhe për Vendet e jashtme.

Pontili i tillë nuk âsht tjetër por nji punë preliminare të të ndertuemit të njij limani të hapt, ku avulloret kanë me mujtë m'u ngjitë bankinavet, i cilli liman — me urdhën të Qeveris Shqiptare — ka qenë projektue prej Senatorit Prof. Luigi Luiggi. Gara e apaltit, e çilun, do të marri fund në majin e afërm.

Vepra e limanit do të plotsohet me vepra të mdhaja tharjeje të knetavet afër Durrësit.

Ndërtimi i hekurudhës Durrës-Tiranë, i dishruem prej Qeveris Shqiptare, do të lidhi kryeqptetin shqiptar me limanin e saj me nji udhë të shpejt edhe do t'i api fytyren e njij Vendi modern, deri më sot pa hekurudhë.

Qyteti i Durrësit i rrenuem para pak kohe prej termekut do të rindertohet mbas njy plani modern rregullues edhe nji varg ndërtesash botore, mbas arkitektures se famshme të Brasini-t, do të plotsojnë kvadrin e zhvillimit edilic të Durrësit e të Tiranës, ashtu edhe të qendravet të tjera shqiptare.

Asht e interesantshme me përmendë ndërtimet e kryeme a që janë për të kryem në Durrës dhe në Tiranë, dhe sidomos

ndërtesat e Bankës Kombëtare të Shqipnis në Durrës edhe në Tiranë, edhe ato të Magazinavet të përgjithshme në Durrës, të bâme prej Arkitektevet Morpurgo, Fiorini dhe Amoruso.

Për veprat e naltpërmenduna âsht pague deri me sot Lit. 9.925.989,92, të ndame njikështu:

A) *Pagesa të bâme para emisjonit t'Uhas:*

Ura hekuri afër Sh'Jakut	Lit.	1.605.277,50
Ura Dragot-Lekli.	»	1.070.185 —
Punë preliminare për uren e Matit. . .	»	535.092,50
Ura në çement Durrës-Tiranë	»	428.074 —
Ura në çement Vorrë-Milot	»	374,564,75
Ura në çement Durrës-Rogozhinë . . .	»	267.546,25
Rruga e Pukës	»	401.319,40
Rruga Elbasan-Korçë	»	347.810,10
Rruga Berat-Fijeri-Ballësh.	»	187.282,40
Rruga Lushnje-Rogozhinë	»	133.773,10
Gjithsejt. . . .	Lit.	5.350.925 —

B) *Pagesa të bame mbas emisjonit t'Uhas:*

Ura e Matit	Lit.	3.616.083,10
Pontili i Durrësit.	»	173.020 —
Limani i Durrësit	»	50.557,50
Hekurudha Durrës-Tiranë	»	735.403,42
Gjithsejt. . . .	Lit.	4.575.064,02

BKSH



SISTEMACJONI I KRYEQYTETIT: TIRANË

Sheshi i Ministrinave.

(*projekt: Ark. Brasini*)

Fyl. e XIII.

PROOF

SISTEMACJONI I KRYEQYTETIT: TIRANË

Ndertesa Ministrore.

(*projekt Ark. Brasini*)

* * *

Tue peshue veprat e kryeme e që janë per të krye nuk mund të harojmë se, mbassì u kryen mjetet e komunikimit edhe mbassì u sigurue dekori i Shtetit të ri me sistematizimin edilic, âsht fort e nevojshme për zhvillim ekonomik të Vendit, që t'uipet fuqì atynve vepravet, që përbajnë nevojen mâ të madhe të rilindjes s'agrikultures.

E me të vërtetë mbi fushen bujqsore pritet të realizohet e ardhmja e bujqësis. Tue qenë se mâ nji anë me komunikimet e rea, që mâ parë mungojshin, krahinat e punueme kanë me mujtë me levizë prodhimet, mungesa e të cillavet veprojshin porsi freni ndalues për nji aktivitet prodhimtar mâ të math, n'anë tjetër vepra shumë mâ të mdhaja duhen për me vue krahina të gjana në gjendje të punohen e që deri më sot pësojnë prej ujnavet të lumenjvet të shumta, me nji rrjedhje të fort, pa iyi rregullim. Mjaft âsht me përmendë viset e Shkodres, ku tokat e frytshme mund të shpëtohen me rregullim të rrjedhjes së Drinit edhe së Bojanes dhe mjafton me peshue dobin e madhe që ekonomija shqiptare do të kishte me pasë me rregullimin — sistematik dhe racjonal të lumenjvet që shkojnë për medis të fushes së gjanë të Myzeqejes, që nji herë ka qenë magaza e grunit të Mbretnìs së Romes edhe sot krahinë e mbllueme me kneta edhe pa nji shteg.

Për me krye studimet edhe riljevet e rregullimit të lumenjvet edhe veprat mâ të vônshme të të thamunit, Shoqnija e

jonë i a ka ofrue Qeveris Shqiptare konkursin e kompetencvet teknike italjane mâ të mira.

* * *

Para se të mbyllim ekspozicjonin e vepres së kryeme, duhet të njoftojmë se në kohë t'ushtrimit, Senatori Av. Angelo Valvassori Peroni ka paraqitë dorëhjekjen si Kryetar dhe Këshilltar i Shoqnis. Këshilli i Administrimit, mbassì e ka lutë shum herë t'a tërheki dorëhekjen mbrapa, nuk ka mujtë me bâ tjetër veç se mjerisht me marrë njoftim që Shoqnija nuk ka me pasë mâ ndihmen e fort e Kryesis së Senatorit Valvassori Peroni.

Mandej me idhnì te madhe duhet të lajmerojmë humbjen e rândë të Drejtorit t'onë të parë, Kav. Antonio Magli, vepra e së cillit ka qenë frymue gjithmon me shpirt mâ të nalt zelli dhe kujdesi. Kujtimi i tij nuk mundet me na dam prej vepravet të realizueme, mbassì ai ka qenë nji element i çmueshëm.

* * *

Bilanci i Shoqnis, më 31 dhetuer 1926, ka nji konsistencë patrimonjale:

Lit. 361.531:765,10 n'aktiv

dhe Lit. 361.011.173,60 në pasiv, me nji ekcedencë

Lit 520.591,50 fitime të dlira, sikur âsht tregue ndër zane të ndryshme të bilancit e të Kontit Humbje dhe Fitime.

BKSH

SISTEMACJONI I KRYEQYTETIT: TIRANË

Sheshi.

(projekt Ark. Brasini)

BKSH



SISTEMACJONI I KRYEQYTETIT: TIRANË

Palati i Presidentit.

(*projekt Ark. Brasini*)

BIBLIOTEKA

Përfundimet llogaritare janë edhe të vërtetueme prej relacjonit të Sindakvet dhe të shkoqituna prej relacjonit të Compagnia Fiduciaria Nazionale.

Si mbas Statutit i proponojmë Asembles me i dam fitimet njikështu:

Për rezerven e zakonshme	Lit.	52.059,15
Për Këshillin e Administrimit	»	26.029,57
Për Komitatin e Administrimit	»	46.853,23
Akcjonisvet:		
5 % mbi kapitalin e derdhun efektivisht . . . Lit. 260.000		
edhe Lit. 0,50 mbi çdo akcjon . . . . . » 75.000		
	»	335.000 —
Në llogari të re.	»	60.649,55
	Lit.	520.591,50

* * *

Këto jane përfundimet e vepres s'onë që i parashtrojmë Asembles për aprovim.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT.

BKSH

BKSH

BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS NË DURRËS

Selija e re që âsht tue u ndertue.

(*Ark. Morpurgo*)

FIL. e XVII.



BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS NË TIRANË
Projekti i Selis së re.

(*Ark. Fiorini*)

BIBLIOTEKA

Relacjon
i këshillit t'administrimit

BKSH

BKSH

LIDHJE 1.

KONVENCJON PËR HUAN PËR PUNËT BOTORE TË SHQIPNIS

(e bâme më 29 maj 1925 ndërnyet Qeveris Shqiptare dhe Shoqnís për zhvillim ekonomik të « Shqipnís, e ratifikueme prej Parlamentit Shqiptar dhe e botueme në » Fletoren Zyrtare n. 36 më 12 Korrik 1925 dhe n. 40 më 31 Korrik 1925).

Tue ju mbështetun Konvencjonit të bamun më 15 Marc 1925 ndërmjet Qeveris Shqiptare Grupit financjar italjan, të ratifikuem, me dekret ligjë po me datë 15 Marc 1925, i nenshkruem prej Kryetarit të Republikës së Shqipnis, Sh. së T. Ahmet Zogut e prej Ministrit të Financavet e zavendës Ministrit të P. të Jashtëme, Sh. së T. Mufid Bey Libohovës e të botuem në Fletoren Zyrtare Nr. 15 d. 18 Prill 1925.

Tue u mbështetë marrëveshtjes përmbaruese të parë të bamun më 15 Marc 1925 ndërmjet t'antarvet të naltëpermendunë, të ndënshkruem prej Ministrit të Financavet e zavendës Ministrit të Punvet të Jashtme Shk. së Tij Mufid Bey Libohovës, prej Ministrit të Punvet Botore Sh. së T. Kostantin Kotës e prej Ministrit të Drejtësis Sh. së T. Petro Pogës, me të cillen Qeverija Shqyptare vendoste t'u afidonte përfaqësuesvet të vet në Romë mandaten për me u dhanë fund marrëveshtjevet për koncesjonin e huas prej 50 miljon frangë ari të parapamun n' artikull 19 të konvencjonit të përmendun.

Tue u mbështetun prokures së veçantë qi i asht dhanë prej Qeveris Shqiptare Sh. së T. Ekrem Bey Libihovës Minister fuqiplotë i Republikës Shqyptare pranë M. së T. Mbretit t'Italis, në bazë sëcillës prokure i epen Sh. së T. Ekrem Bey Libohovës fuqi të plotë për të bamun të gjitha marrëveshtjet qi i perkasin kësaj huaje.

Ndërmjet të Qeveris së Republikës Shqyptare të përfaqsueme rpej Ministrit të Financavet e Zav. Ministrit të Punvet të Jashtme Shk. së Tij Mufid Bey Libohoves e për ate prej Ministrit Fuquiplot Ekrem Bey Libohova, nga nji anë dhe Grand Ufficiale Mario Albertit, Minister Fuquiplot nderi, si përfaqsues i Grupit financjar italjan si mbas konvencjonit të naltëpërmendun 15 Mars 1925 e i Shoqënis për shvillimin ekonomik të Shqipnis, nga ana tjetër mbetet e caktueme dhe e konvenueme si vijon:

Art. 1. — Për me siguruem mjetet financjare per mbarimin e vepravet botore mâ me randsi që do të bahen në Shqipni, do të bahet nji hua me titull: « Hua për punët botore të Shqipnis 7.50 për qind 1925 ».

Shuma qi do të dali prej kësaj huaje do të jet Frangaë ari 50 (pesëdhjet) miliona ose ekvivalent në valutë të tjeter.

Si mbsas artikullit 22 të konvencjonit bazë të naltëpërmendun, si edhe në bazë të marreveshtjes përmbaruese të pare, të nenshkrueme me 15 Mars 1925 në Tiranë prej Shkelqësis së T. Mufid Bey Libohovës, Kostantin Kotës e Petro Pogës për Qeverin Shqyptare, prej Gr. Uff. Mario Alberti për Grupin financjar italjan, shuma qi do të mbilidhet prej huas do të përdoret vetëm për ndertim limanesh, urash e rrugash, per vepra përmirësimi tokësh, tharje kënetash e mocalësh e për vepra të tjera qi interosojnë shvillimin bujqësuer të vendit, per goditje udhë-hekurash, tramway, verprash idraulike, për ngrefje telefonash e telegrafash, per shfrytëzim pyjesh.

Sikunër âsht parapa marrëveshtjen permbaruese të dytë, me datë 15 Mars 1925 e të nenshkrueme prej Shk. së T. Libohova, Kota, Poga dhe Alberti, Qeveria Shqiptare do t'i jap Shoqnis për shvillim ekonomik të Shqipnis listen e plotë të gjita punvet botore qi do mund të bahen me shumen e mbledhun prej huas. Shoqnija për shvillim ekonomik të Shqipnis do të merret vesht me Qeverin Shqyptare për me caktue rendin e precedencës të punëvet të ndryshme. Shoqnija për shvillim ekonomik të Shqipnis ka me mujtë me i proponne nden titull këshilli. Qeveris Shqyptare te kryemit e punvet qi nuk jane të parapam edhe në listen e caktueme mâ naltë.

Për te kryemit e punvet botore të zgjedhuna, Shteti Shqyptar ka për t'i lanë në dorë të Bankës Komtare të Shqypnis të provokojë e të pranojë ofertat e duhuna. Do të zgjidhet oferta ma e mirë nga të gjitha pikëpamjet për Shtetin Shqptar, d. m. th. ajo qi do të ket kondita mâ të mira çmimi, bashkë me serjozitetin, kapacitetin teknik e garancin financjare ma të madhe të sipermajes paraqitse. Per shqyrtimin e këtyne ofertavet Banka dhe Komisjoni munden me zgjedhë sistemin qi do t'u duket ma i përshtatun si për sembull sistemi i ankantit publik me oferta në zarfa të mbylluna.

Ne çdo rasë Banka Kombëtare e Shqypnis, sikur âsht parapa n' art. 23 e 26 të konvencjonit bazë të permendun, do të kete preferencen t'i jape Shoqënis per shvillimin ekonomik të Shqïpnis a

Shoqnivet të mvaruna prej saj a me tê të lidhuna, punët e veume n' ankand e kjo gjithnji në konditat ma të mirat per Shtetin Shqyptar nga të gjitha pikepamjet nalt të caktueme.

Shoqninavet qi do të marrin pjesë n'audjudikatë per punëra botore qe do të kryheu, si u parapa mâ naltë, dhe veçanarisht shoquinavet për goditjen e rrugave, duhet te porosited nxehtsisht të marri në nji masë, sa të jetë e mundur me të gjerë, puntorë Shqiptar. Per Shoqërinat në fjalë duhet të marrin, gjithmonë sa të jetë e mudur, punëtore Shqiptare në proporcjon 75 % për quid. Personali teknik do te jet shqiptar a të njy kombi tjeter.

Pegesat e veprave të P. Botore qi kanë me u bamun me të hollat e huas, do të kryhen mbas urdhënit të shkruem të Qeveris Shqiptare prej Shoqnisë per shvillimin ekonomik të Shqipnis e cilla do të depozitojë shumen e huas së nxjerun në Banken Kombtare të Shqypnis a në nji nga ma të parat Banka t'Italis po qe se Banka Kombtare e Shqypnis në kohen e emisjonit të huas nuk do të ket fillue me veprimet e saia.

Në mbështetje të marrëveshtjes zbatuese të katert të 15 Mars 1925 të nenshkrueme prej Shk. Tyne Libohova, Kotta, Poga e Alberti, shuma e uhas nuk do të perdoret kurr per manutencjonin e veprave botore mbasi Qeverija Shqyptare do të kujdesohet vetë me mjetet e veta per të tilla shpenzime.

Art. 2. — Rimborsimi i kapitalit të detyrmit të « Huas per punët botore të Shqypnis 7.50 për qind 1925 » si edhe pagesa e interesavet relative garantohen prej Shtetit Shqyptar me anë t'ardhunavet vijuese, qi Qeverija Shqyptare me ktê deklaron solemnisht dhe irevokabilisht tash të lira e se nuk do të pësojne në kohen e ardhshme asnij barrë, te « drejte », peng, garanci ose ngarkese të c'do natyre ose lloji; prodhimi i këtyne t'ardhunavet âsht caktue prej Qeveris Shqyptare per garanci të huas në mënyre esklusive të pajetertueshme dhe të pambrapathirrshma, deri n'amortisimin e plotë të kësaie huaje:

Të hiemet doganore ne nji t'ardhun prej gjashtëmiljon franga ari në vjetë Monopole të Shtetit mbi krypen, mbi letra cingarit, mbi letra loje e mbi shkrepcat me nji t'ardhun të parapam prej frangash ari dy miljon e gjysmë, d. m. th. pergjithësishtë franga ari tetë miljona e gjysmë (8.500.000). Në bazë të kësaj garancije, Qeverija Shqyptare ep, deri në mbarim të afatit t'huas, mandatë per me

lype, në favor te Shoqnis për shvillimin ekonomik të Shqypnis, për të gjitha pagesat e përvjetëshme, amortamente e shpenzime të huas. Këto pagesa do të bahen për do muej, në favor të Shoqënis per shvillimin ekonomik të Shqypënis në Romë, së cilës i perket sherbimi i huas, me të holla të nxjerruna prej të hymevet doganore e të monopolevet të dhanuna në garanci me të drejte preference absolute edhe të parevokueshme karshi çdo barre e ngarkese tjeter.

Kur për çfarëdo shkak shuma e çfarëdo mandate nuk do të paguhet n'afatin e caktuem, per murgesë së pagëses, detyrohen në favor të Shoqënis për shvillimin ekonomik të Shqypënis posë të gjithë shpenzimevet qi për këte shkak do të bajë Shoqënija, interesat e mores tue i llogaritun 2 për qind mbi interesen e huas e si do qi të jét jo mâ pak se dy per qind mbi taksen zyrtare të skontit të Bankës Komtare të Shqypnis. Shuma e përgjithshme e këtyne interesavet more e të shpenzimevet do të formojë pjesë të pandame të huas edhe mbi këto do të quhen të dhanuna të gjithë garantitë dhe privilegjet e parapame për kistet e amortamentit.

Qeverija Shqyptare ka per të vue per ç'do vjetë në pasiv të bilancit të vet ndermjet të shpenzimeve të domosdoshme edhe për të gjithë periudhen e amortamentit pagesat e përvjetshme qi i detyrohén sherbimit të huas.

Në rasën në të cilen mbas nji paksimit t'ardhunavet, te taksavet, tatimevet e të taksave të tjera në fjalë shuma e parapame prej Fr. ari 8.500.000 do të paksohet, Shteti Shqyptar do të jet i detyruem të mbushi deficitin tue shenjue t'ardhuna të tjera tatimesh a të hymesh dhe me aktivitete të tjera.

Qeverija Shqyptare lidhet solemnisht e ne mëuyrë të pa kthyeshme të mos bajë për sa kohë qi të qindrojë hy kontrakt ndryshime që mundetë paksojn t'ardhurat e gjitmarshme të Doganavet të shenjueme e të dhanuna në garanci të huas pa qenë ma parë e marrum vesht me Shoqënin për shvillimin ekonomik të Shqypënis për me dhanë per garanci të huas të hyeme a aktivitete tjera qi të jën të pelqyeme prej Shoqënis.

Art. 3. — Detyrimet e huas per punët botore të Shqypëniës do të qiten, si mbas pelqimit të grupit financiar italjan e për ktë të Gr. Uff. Mario Albertit, në njenen ose në tjetren prej dy formavet qi vijojnë.

a) Detyrime të drejtueme prej Shtetit Shqypëtar e qi kanë garanci të shenjueme n'artikullin e përparëshem.

b) Detyrime të qituna prej Shoqnis per shvillimin ekonomik të Shqypënis me ndeje në Romë (Albany's Economic Developpement Corporation; Companie pour le developpement économique d'Albanie; Shoqënija per shvillimin ekonomike të Shqypënis; në favor të cilavet Shteti Shqypëtar do t'i japë po ata garanci të parapame n'artikullin e ma parëshem edhe të tilla sikur cillësija e tyne të kishtetë bante me detryme të drejtueme prej Shtetit Shqypëtar.

